



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 154/1 Prot

Përmet, më 28 .01 .2026

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion

Referuar kërkesës Tuaj për informacion datë 14.01.2026, drejtuar Bashkisë Përmet , ju bëjmë me dije si mëposhtë:

1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2025?

Bashkia Përmet ka ofruar mbështetje për organizatat jofitimprurëse si për ato që ushtrojnë aktivitetin në Përmet por edhe për organizatat që veprojnë jashtë Përmetit por sjellin projekte të rëndësishme për qytetin nëpërmjet thirrjeve për projektpropozime por edhe mbështetje të kërkesave të OJF-ve të cilat sjellin aktivitete innovative dhe të përshtatshme për komunitetin tonë.

2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa ka qënë buxheti i shtetit i alokuar vetëm për mbështetjen e organizatave gjatë vitit 2025? Sa nga ky buxhet u disbursua tek OJF-të.

3. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qënë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)?

Mbështetja financiare ka qënë në formë granti por edhe me Kontratë Shërbimi.

4. Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2025? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë së një formë.

Në kuadër të zbatimit të Programit Reload, bashkia hap thirrje për projekt propozime në bazë të prioritetëve të përbashkëta që Bashkia dhe OJF-të kanë. Sipas këtij programi mbështeten në varësi të fondeve organizata duke ju dhënë fonde dhe duke monitoruar ecurinë e zbatimit të projekteve. Për vitin 2025 kanë aplikuar 3 OJF.

Një formë tjetër është nëpërmjet granteve ku Bashkia në kuadër edhe të zbatimit të projekteve me financim nga BE, mbështet biznese dhe startupe.

Disa shoqata si “Promotor”, “Albania Ska Problem”, “Marton Albania” , “Deliart” etj kanë projekte që dëshirojnë ti zbatojnë në Përmet dhe duke ditur impaktin që sjellin këto aktivitete masive në Përmet, Bashkia përveç mbështetjes në mbarëvajtjen e aktivitetit, ofron dhe mbështetje financiare. Për vitin 2025 janë mbështetur me Kontrata Shërbimi 4 shoqata.

5. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur më shumë se një formë

Sipas thirrjeve të Programit Reload kanë përfituar mbështetje 3 shoqata.

Me Kontrata Shërbimi kanë përfituar mbështetje 4 shoqata

6. Cila ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë

Nr	Shoqata	Buxheti për vitin 2025	Forma e mbështetjes
1	Shoqata “Përmeti Futboll Klub 1930”	2 000 000 Lekë	Grant
2	Shoqata “Vjosa Explorer”	3 000 000 Lekë	Grant
3	Shoqata “MKEZH”	1 000 000 Lekë	Grant
4	Shoqata “Promotor”	1 000 000 Lekë	Kontratë (me sponsorizime)
5	Shoqata “Albania Ska Problem”	300 000 Lekë	Kontratë
6	Shoqata “Deliart”	100 000 Lekë	Kontratë
7	Shoqata “Maraton Albania”	200 000 Lekë	Kontratë

7. Keni ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2025? Cila është baza ligjore/ rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje?

Bashkia Përmet i konsideron bizneset dhe OJF-të që veprojnë në Përmet si partnerët kryesorë dhe si të tillë ato janë gjithmonë të pranishëm për të konsultuar akte të rëndësishme dhe marrë vendime gjithashtu në të mirë të komunitetit dhe punës së përbashkët.

8. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)?

Mbështetje financiare kanë përfituar shoqatat e përmendura në pikën 6. Mbështetje jo financiare ka qenë mbështetja me ambiente, foni, staf mbështetës etj sipas nevojave që kanë shoqatat gjatë zbatimit të aktiviteteve, pjesëmarrje në aktivitete të Bashkisë, në procese konsultimi etj.

9. Keni nënshkruar kontratë për mbështetje jofinanciare? Nëse Po, cila është baza ligjore për ofrimin e kësaj mbështetje?

Përgjithësisht është ofruar mbështetja pa ndonjë KONtratë të mirëfilltë, thjesht I jemi përgjigjur nevojës së shoqatës për zhvillimin e aktivitetit.

10. Cili është numri i takimeve monitoruese nga numri total i projekteve fituese që keni kryer gjatë 2025? Lista e kriterëve monitoruese.

Për projektet që shoqatat zbatojnë në kuadër të thirrjeve që bashkia ka publikuar, pas fillimit të zbatimit të projektit, kryhen procese monitoruese cdo 3 muaj. Pra për projektet e zbatuara në vitin 2025 janë kryer 9 procese monitorimi për 3 projekte që po zbatoheshin. Gjithashtu realizohen dhe 3 monitorime të buxhetit në të cilin përfshihen dhe monitorimi për buxhetet e projekteve me financim të huaj dhe projekte që bashkia është financues.

Kryeshisht monitorohet cilësia e zbatimit të aktiviteteve pjesa administrative dhe financiare nëse shpenzimet përputhen me buxhetin e miratuar dhe aktivitetet e planifikuara.

11. A është bërë një vlerësim impakti mbi fondin e disbursuar ndaj organizatave jofitimprurëse? A keni një raport të tillë vlerësimi?

Raporti i vlerësimit pas cdo raporti tregon dhe impaktin që ka patur zbatimi i projektit.

12. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2024?

Konsultime publike të realizuara nga Bashkia Përmet gjatë vitit 2025 kanë qënë rreth 9 konsultime ku secili ka patur edhe takime 2-3 herë.

Linku i publikimeve : <https://bashkiapermet.gov.al/konsultimi-publik-2025/>

13. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.

Po, Bashkia Përmet ka Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Të dhënat: <https://bashkiapermet.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>

14. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.

Jo nuk ka ende një Koordinator për shoqërinë civile.

15. Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga Institucioni juaj?

Në konsultimet e organizuara nga Bashkia Përmet kanë marrë pjesë përfaqësues nga 7 OJF që veprojnë në Përmet.

16. Sa përqind (%) e projektligjeve / akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-të?

Rreth 20 % e akteve që harton Bashkia dhe miraton Këshilli Bashkiak.

17. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshirë në to?

Përfaqësues të OJF-ve janë pjesë e organeve këshillimore të bashkisë si Këshilli Vendor për Sigurinë Publike, Këshilli vendor Rinor etj.

18. A janë të përfshirë OJF në grupet e punës së ngritura të institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshirë në to?

Një ndër grupet e punës së ngritur për procesin e vlerësimit të project propozimeve të aplikuara nga OJF .

Duke ju falenderuar,

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Denisa DURRO

